

Drithërimat e pranverës

Këtu e kemi shtëpinë

Qe një natë zezë sterrë
karakolli në bedenë
bënte serasqerit benë

Karakolli në Larisë
pirë në suljote sisë
i dërgon selam Turqisë

Mos me djem't e Shqipërisë
bie një e mbin një lis
gjir'i furtunës teftis

Serasqer, hiqe ushtrinë
se këtu kemi shtëpinë
aty kemi dhe Alinë

S'vimë në troje të tua
truallin tim, e tjetër s'dua
balta me gjak u gatua.

Nëpër glob bridhnim bashkë

"Nipit tim, Manfredit ëngjëllor"

Do doja të të merrja kalikiç
i vogël, i ëmbël siç je
nëpër glob, bashkë të bridhni
ta shihnim botën si qe.

Po ti je i vogël, o nip
dhe unë po thyhem ngadal
për mua nuk vjen ajo ditë
për ty do vijë, se je lastar.

Dhe kur të vi, kujtomë dhe mua
buzëqesh, ashtu si tani
buzëqeshja jote do më zgjuaj
dhe sikur të jem në përjetësi.

Drithërimat e pranverës

Drithërimat e këngës
vallë kush s'i ndjeu
kush iu ul në prehër
dhe zemrën s'e ngjeu?

Ato drithërima janë
drithërimat e praverës
drithërimat e një vajze
kur sheh gjirin sa ka çelur.

Ato drithërima janë
drithërimat e një nëne
kur lind fëmijën e parë
dhe haron që hoqi dhëmbje.

Ato drithërima janë
të pafundme në një jetë
ikin e të hapin varrë
vijnë e të ngjallin prapë.

Drithërimat e këngës
janë të pasosura
i kam brenda gjirit
ndaj nuk u marrosa. . .

I kam brenda gjirit
dhe mua më rrinë
kush nuk njeh këngën
nuk njeh drithërinë.

Isha. . . .

Isha gonxhe, thashë do çel
isha fillad, e thash do fryj
isha zjarr, e thash do ndez
isha hënë, e thashë do ndrijë.

Isha këngë, e u këndova
isha mall, u përvëllova
isha ëndërr, u kërkova
isha shpresë, nbijetova.

Isha jetë, mbeta jetë
një binjak me varfërinë
kasollja më mbeti shkretë
vetëm miqtë e mi më vinë.

Isha këngëtar i parë
kisha sedër Labërie
Meço Mukës lundërtar
pas i shkoja si një hije.

Pas i shkoja, pas i vete
si mit e unë në këmbë
shkul një shkëmb tek lagin dete
këngët labe vendin zënë.

Moj portokallia nga Vlora

Moj portokallia nga Vlora
dola bregut të kërkova
sa të gjeta si durova
puth e puth, mallin s'ta nxora.

Portokallia thelbinjshumë
nuk më le të bëja gjumë
po m'u qepe si shushunjë
ngjitur lëkur' më lëkurë.

Ngjitur si boçeja tek pisha
të furfullonte këmisha
isha unë, a unë s'isha
më këmbë valën përpifsha.

Ikte vala hargalisur
s'sosej puna që kish nisur
kthehej prapë e zalisur
s'rinte dot pa na cingërisur.

Moj portokallia nga Vlora
puth e puth, mallin s'ta nxore
puth e puth, s'ta nxora mallin
puth e puth, s'ta shova zjarrin.

Në breg të Balile rri

Në breg të Balile rri
sa ka rënë buzëbrëmja
përkëdhel me dhëmbshuri
boçet, gjembaçe, gështenja.

Thonë tek ajo gështenjë
është varrosur gjyshi im
thonë, se varrin s'ia gjejmë
s'e mbajnë mend në Rexhin.

Bëma e tij i kamë gjetur
atje tek Shesh'i Xhamisë
thonë ishte burrë i pjekur
thonë gjendej për të gjithë.

Thonë i peshonte fjala
i peshonte burrëria
kur plagë mernte mëhalla
gjendej Shaqo Bukuria.

Në bregë të Balile rri
ne Rexhin të Kurveleshit
krahët zgjati një qersh
dhe m'u bë shpargër i djepit.

Dhe në shpargër në vjen gjyshi
brenda gjirit më rrëmben
vitet nga supet më ikin
unë kërktoj, ai më gjen. . .

Pse i thonë gjiri i detit

Pse i thonë gjiri i detit?! . . .
të ma thotë kush e di
rropatem ta gjejë i shkreti
se mua s'më duket gjiri.

Unë gjiret i kam parë
se si mbinin tek një vashë
dhe me dorë i kam ngarë
dhe të ngarë, nuk i lashë.

Gjiri i detit është i fshehur
gjiri i vashës është i dukur
gjiri i detit e puth bregun
gjiri i vashës pret të puthur.

Gjiri i detit është i zbutur
gjiri i vashës është i sertë
gjiri i detit loz me shkumën
gjiri i vashës dhe pëllcet.

pse i thonë gjiri i detit?! . . .
të ma thotë kush e di
kot ia ka futur i shkreti
nuk ka parë kurrë gjë.

I them.

I them penës: ç'ke që shkruan
dhe dalldisë si e marrë
kush i do këngët e tua
kush i do me barkun tharë.

I them zjarrit: ç'ke, që s'ndize
edhe shpuzën ç'e ke bërë?
qënka tretur nëpër vite
qënka bërë hi e tërë.

I them zemrës: ku ke gjakun
që të derdhej si burojë
qënka bërë si farmaku
qënka bërë aq i hollë.

I them malit: ku ke majën
paska rënë në kënetë
i them nuses: ku ke pajën
tretur në një varr të shkretë.

I them detit: ku ke valën
që londron me pulbardhë?
paska ikur si e shkalur
në brigje të tjera dalë.

I them kombat: djemt' ku janë
që venitën këto nëna?
arratinë kanë marrë
kanë mbetur atëhëna.

Djalëria

Djalëria, djalëria
ajo moshë, që s'vjen prapë
ëndërr zgjohesha e flija
ëndrra turrja nëpër natë.

Nëpër ëndrra ato vasha
mblidheshin në gjirin tim
pa më behej zemra ashra
se më iknin në agim.

Në mëngjes para pasqyrës
shihja buzën, ç'kishte ngjarë
të flinte me kaq të puthur
dhe plagë të mos kish marrë?

Ato flokë të mëndafsha
që më derdheshin në gushë
nuk e panë ç'lanë mbrapa
atë zjarrë e atë prushë.

Djalëria, djalëria. .
erdhi sot në këngën time
i hutuar s'di si rrija
i harruar në kujtime.

Përflaku lindjen agimi

Përflaku lindjen agimi
zuri gjindja të gjalloj
nisi bleta fluturimin
mbi lule të kalërojë.

Zë bilbili, bilbiloi
flet'më fletë, degë më degë
thëllëza folenë ndërtoi
u ngjit maleve përpjetë.

Dhe fluturat krahëshkruar
bredhin nëpër lëndin
ikën e s'ka të larguar
dhe humbet e prapë mbin.

Dielli e nxori syrin
mbrapa malit gjithë gaz
mbi rrushkuqe zog'i bukur
i vete zogëzës pas.

Përndezi dielli agimin
zuri gjindja të punojë
zemrën më bloi mendimi
pse s'qenka jeta njësoj?

Valltari Lab, Alush Milori

O shokë do vdes me këngë
dhe me këngë te m shpini
gurë varri kokë e këmbë
këngën labe të më vini.

Dhe zogjtë malit do thonë
këtë këngë kush e përcolli?
nëpër kohë do gjëmoj
vallja nga Alush Milori.

Atë valle aq të rëndë
që ngriti lebrit në këmbë
ta hedhim të ndizet flakë
se ngrihet Alushi prapë.

U ngre e foli me gojë
vet i pari vallen nisi
majëkëmbe ligjëroi
"Dyfeku krahun na grisi"

Na grisi dyfeku krahë
na zhuritën, dot s'na thanë
na qëlluan, dot s'na vranë
me dhëmbë mbjatën vatanë.

O shokë do vdes me këngë
dhe më këngë të më shpini
që varri bar të mos zërë
një këngë labe më bini.

Miro të vranë vëllanë

Hapi udhën shkëmb'i sertë
se shkoi Miro Tërbaçia
çepen prerë si djemtë
rrëmbyer shpuzën nga vatra.

Trok i kalit s'ka të shuar
nëpër ditë, nëpër natë
shtigjet e malit kafshuar
supeve të fushës, plagë.

Yjet bëjnë sikur dalin
dhe mëngjesi sikur mbin
shkumë e bardh' në gojë të kalit
re e zezë me vetëtimë.

Farfurin çadër e pashait
rri orgjia këmbëkryq
skuq plumbi lulen e ballit
malet hapën mushkritë.

-Miro te vranë vëllanë! . .
-Heshtni, se e kamë të gjallë,
shkoni pyesni pashanë
në i gjetshi dotë nishanë. . .

Bajroni dhe unë

Mbi këtë kala të lashtë
ulem, kridhem në mendime
unë dhe Bajroni bashkë
të shtyjmë këtë mbasdite.

. . . Anglezi, bir i revoltës
bie shekullin e shkuar
unë pikoj fundin e gotës
këtij shekulli të harbuar.

i them Bajronit: Pse ike?
përse ike nga Anglia
ti s'dije se ku binte
as në hartë Shqipëria. . . .

Po Bajroni zuri qeshi
ngriti gotën mbushur plotë
-Koha jonë ashtu e deshi. . .
të ishim të gjithë tokë.

-Ti bën këngë për Alinë
e njohë Alinë vallë?
unë tani sikur të vijë
ngrihem i japë silanë.

unë e di, s'arrita dot
që të vdisja n Angli
po e di zemra më thotë
ti do vdesësh në Shqipëri.

Unë shtrëngojë gotën e shkundur
shtrydhur si shekulli im. . .
hodha synë, Bajroni zhdukur
mbetur unë dhe një vegim.

Ajo që dua s'më la

Po përtej shullërit ç'ka
është mbushur vashëza
lozin e bëjnë shaka
desha që të puthja ca
ajo që doja s'më la
loz e qesh e çoç më tha
Ç'ke kështu o budalla
ato janë kumbulla
janë të papjekura
po ktheje syrin nga unë
pjeshkë pjekur nazeshumë
në s'të lënça të pagjumë
kurrë mos fjetsha me burrë.

Fol more Zubo Hormova

Zubo trimi kordhëtari
sorkadhi që zbret nga mali
valle mbi armiqtë fustani
më dy presa jatagani
po sa preu e sa griu
sa u sos gjithë osmanlliu
aq sa dielli kur mbiu
u ul, jataganin fshiu.

Ajo Lirua sumbullesha

Shkon Lirua posht'e përpjet
ajo Lirua sumbulleshë
e bukur xhinde vetë
majëkëmbë aq e sertë
u sëmur ilaç mos gjetë
të vete ta shëroj vetë
ti puthë atë faqe shegë
pa të tjerat vijnë vetë.

Do marr penën për të shkruar

Do mar penën për të shkruar
me zemër të përvëlur
se kamë hequr e kam vuar
për një këngë përgjëruar
sharkun shtruar e mbuluar
lotin në prehër pikuar
për një dashuri të shuar
e pres e më ka haruar.

Hamit Guga Progonati

Nëpër kohë Hamit' i Guge
më ngacmon legjenda jote
bëj të iki e s'bëj tutje
s'më lë çibuku prej shqope.

Ai çibuk Progonati
që theu dhëmbë valiu
vetëm inatin e tij pati
a dhe timin pas vetiu?

Thonë Hamit trëndafili
luftoi i vetëm filli
po dinte ku qe burimi
tek s'njihej trimi nga trimi.

Tek labja me furkë në dorë
tirrte mbrëmjesh burrërinë
thyen kokën taborët
s'mernin dotë një Bohotinë.

Nëpër ditë, Hamit Guga
rri tek Rrapi i Progonate. .
në supe më rrinë pëllumba
dhe legjenda jote fshtaçe.

Unë s'kamë thënë gjë

Do ta këpus hënën
një natë behari
si gjerdan i vashës
në gushën e bardhë.

Do t'iu them gjetheve
fëshfërimën të ndalin
dhe burimeve të nderojnë
rrjedhën e parë.

Do ti lë culat
të gjitha pa punë
zilet e këmborët
në gjumë do ti vë.

Valët e detit
do ti lë pa shkurë
dhe zogjtë pa cicërima
do ti lë.

Të gjitha, të gjitha
do ti bëj, më besoni
thoni është i shkalë
është i lojtur, thoni.

Që ju do ta thoni
unë e di këtë
në ardh'sonte mikja
unë s'kam thënë gjë.

Këngëmall, në këngë s'u plake

"Artistit të meriutar, Golik Jaupi"

Një jetë, zemra në këngë
një këngë rrjedhur në buzë
cilët varg, shpirt s'i ke dhënë
cilat këngë s'të ndezi shpuzë?

Kohët ikin, ti në vite
ulur nëpër këngë labe
këngëmall, në shpuzë u rrite
këngë zjarr, në këngë s'u plake.

Dëgjohet në mal një qyq

"Benard Dervishit, Fatos Kalemit"

Dëgjohet në mal një qyq
gjëmën hap në Tepelenë
thëllëza, këngët bëri ligje
si s'kish bërë ndonjëherë.

Dy yje, yje të bukur
u këputën në një ditë
njerëzia, Zotin lutur
loti, lotin nuk e prit.

Në dervishaj s'paska gjumë
edhe hëna është përgjakur
burrat cigarin në buzë
nuset për një natë plakur.

Një dyfek e se nga erdhi
buzëbrëmja sa pa rënë
tek Islami vjen haberi
hap, noj Metullahe gjëmë.

Ç'hyri marsi kaq i rëndë
përse hyri i përgjakur
amanet, moj toka mëmë
mbaji ngrohtë, mpiksur gjaku.

Mos e vyshk rininë e tyre
dhe mos ua prish bukurinë
ruaju rininë e syve
ta gjejn' nënat, kur të vijinë.

E shtrydha majën e penës
e shrydha e derdhi lot
Nardi me Tosin më erdhën
edhe këngën e bëmë tok.

Hajdut i dashurisë

Hyra një natë në baçe
u futa mes luleve
pak i frikur, mos më pe
kur dole në penxhere.

Pak i truar flas me fletë
amani lëvizni lehtë
trëndafil futu në xhep
po doli të dhuroj vetë,

Kur luaje më perde
linja sipër gjireve
mu duk sikur fare s'qe
buzët e mia atje.

Po të pashë ashtu si je
hedhur flokun supeve
dredhur ëndrrat netëve
kryebëjkë në kope.

Si hajdut i dashurisë
u drodha rrotull shtëpisë
thash që murin do ta ngjisë
të grisë të bardhën këmishë.

Nuk e di se çfarë kam bërë
si jam sjell, si të ka thënë
në mëngjes gjeta në llërë
një nishan më dhëmbë lënë.

Ç'është ashtu në ato male

Ç'është ashtu në ato lugje
s'mbeti paçelur burbuqe
luleshqerra, lulekuqe
u bënë lulet si nuse.

Ç'është ashtu n'ato korie
ndënë lis e s'ngopej hije
çobank'e vogël ku rrije
djersën me mëngë e fshije.

Ç'është ashtu n'ato burime
një gushë ujë tu hedhësh syve
mblidhen vashat trëndafile
supet mbledh kur thonë, zgjidhe.

Ç'është ashtu në ato male
pse s'më thoni, ç'është ashtu
kuac'e kuqe xanxare
vjen e më ulet në gju.

Meritokracia

Meritokracia
kjo fjalë kaq e re
më vë në dyshime
më duket hile.

Më vë në dyshim
më vë në mendin
është merit pune
apo për partinë.

Në është për partinë
qoftë atje ku është
partia që iku
ka lënë një kësht.

Paska lënë një kësht
paguar më parë
rrini sa të rrini
e kemi me radhë.

Në është për punë
s'më duket ashtu
se në vend të bimës
po mbillet një hu.

Meritokracia
meritokracia
të ishte si thoni
i papunë do s'rrija.

Më duket një bushtër
që hiqet aq shumë
sa të gjithë zagarët
mburren, "e kam unë"

U bë jeta psherëtimë

Dola në portë të rri
sabahut me mugëllirë
bjerme kafenë, moj bijë!
monopatit hodha synë
na u bë jeta borimë
lanet kush nxori mërgime
mbushi vendin me jetimë
mori loti rrokullimë
lanë thëllëzat kuvlinë
u bë jeta psherëtimë.

Një lule

Një lule në portokalle
jap ta zbus e më xanaxare
jap ta pak e më e madhe
ma mbushi jetën me halle.

Një lule ndënë limua
bëj ti flasë e thotë s'dua
bëj ti qasem, s'rri me mua
bëj ta ngas e m'u largua.

Një lule ndën mandarinë
më farmakosi të zinë
se më zbuloi pusinë
më tha ik, se jamë kërthinjë

Një lule në një shkëmb deti
më kërkon takëme mbreti
nuk donte povexgë djepi
se e pashë e ashtu mbeti.

Një lule në një zangua
sa më pa u trubullua
sa më pa e u hutua
e mori udhën me mua.

Ago Felek Çelës

Shkëmbi, shkëmbit flet me fjalë
edhe dheu zë rënkton
re e zezë mbi Gusmar
s'hedhka shi, por lot pikon.

Vetëtimë s'shkrepri reja
vetëtimë ishe ti
Ago Feleku pa eja
le të rrjedhë loti shi.

Pa eja, folmë njëherë
siç flisje me Mareglënë
kur trimat qenë e nga s'qenë
për liri e bën benë.

Se u tund Kurveleshi burrë
të sertë si malet vetë
burofshin gjithnjë si gurrë
ikin vetë e lënë djemtë.

Shkëmbi, shkëmbit i flet me fjalë
janë shkëmbinj Shqipërie
edhe pse nuk je i gjallë
sot në këngë do më vije.

Do më vije, Ago Çela
i heshtur e fjalëpakë
brenda gjirit tënd shpërthyer
i përflakur një bajrak.

Atë nishanin në ballë

Atë nishanin në ballë
mendothem kur e kam parë
kur s'kesh lerë a kur jesh djalë
a kur jesh me këmbë në varr?

S'kujtohem ç'stinë ka qënë
dimri me borë të rëndë
apo pranvera me hënë
a mos vjeshta gjetherënë.

S'di në ishte ditë a natë
atij behari me vapë
që më vuri në lëngatë
u faneps e iku prapë.

Xixëllonjë vezulloi
lozi me vetull e shkoi
lanet pastë më përvëloi
s'më ftoh dot i gjithë kroi.

Atë nishanin në ballë
mendothem kur e kam parë
doemos kur isha djalë
sevdaja s'do më dalë.

Kur bie cula dyjare

Kur bie cula dyjare
Pushojnë zogjtë në male.

Kur bie cula pagdhirë
më mbushin lulet avllinë.

Kur bie cula në vapë
gjiri vashës ndizet flakë.

Kur bie cula në verë
mikja del më pret në derë.

Kur bie cula në vjeshtë
mikja nusërinë pret.

Kur bie cula në borë
mikja nuk më flet me gojë.

Kur bie cula dyjare
nuk derdh tingujt, por derdh halle.

Nuk e shihni. . .

Nuk e shihni, që u mpaka
nuk e shihni, që u treta
sa dhëmbje mbi supe mbajta
sa ilaç për to nuk gjeta.

Nuk e shihni që po digjem
si eshka nga dalëngadalë
nuk e shihni, si po piqem
si Çaush Hormova gjallë?

Nuk e shihni, që s'kamë qumësht
të ushqej foshnjat në djep
s'e shihni, që po më shqepin
kopsa nderi në jelek?

Nuk më shihni, që jam shkoqur
nuk më shihni, që jam kotur
nuk më shihni, jam përlotur
nuk më shini, jamë gjakosur?

Nuk më shihni, pse s'më ngrini
krahë shqiponje më vini
lezet të ketë fluturimi
dheu i Arbërit, është yni.

Djemtë e Rexhinit

Djemtë e Rexhinit furtunë
ne Senic' vanë e u ngulnë
luftë me halldupin zunë
i rri kllëç në hundë.
Flet Hasan Jahua një fjalë
mos lini asnjë të gjallë
kemi hak për të marrë
na kanë zënë vatanë.
Djemtë e Rexhinit më derte
lerë e rritur me dyfeqe
i rrinë hasmit mbi vete
fol vatani ata:lepe!

Pse m'u plake shqipëri

Shqipëria për një natë
ish e re e u bë plakë
ish e re u gdhi gërmuqe
njëmijë halle mbi supe.

Malet e Greqisë ç'mbajnë
edhe deti pse nuk fletë
ata djem që vare s'kanë
atë mall, që nuk u tret.

Sa vasha rininë dhanë
në atë të shkret' Evropë
lanë nënat e ç'nuk lanë
vunë qefinin në kokë.

S'i kish parë Evropa kurvë
thëllëzat e malit borës
që të bridhnin nëpër udhë
të nxirnin bukën e gojës.

I kish parë i kish dëgjuar
ngjeshur brezit jataganë
për dhe babe përgjësuar
dhe për nderin honesh rarë.

O ju vasha, o ju yje
o ju djepe Shqipërie
o ju shqiponja stuhie
kthehuni, ku diell bie.

Vij e ta gjej folenë

Shegë e kuqe flakërimë
s'erdhe një nobet të rrimë
ujë të ftohtë të pimë
tek ai burim që pimë.

Atje te kreh veriu
dhe thëllëza grykën lajnë
tek bie cula vetiu
dhe ha inat me longar.

Tek mbushet lule lëndina
dhe derdhen këmborë e zile
tek shkojnë vashat e dlira
supetundur, shtegut dhive.

Faqeshega, kuqerremë
pse ma meron djalërinë
bëhem zog pemë më pemë
dhe vij të gjej kuvlinë.

O ju vashat e bukura

O ju të bukura vasha
eja futmëni në këngë
ju jap fjalën po u ngafsha
Zoti pa sy të më lërë.

Ejani si fllad pranvere
të lehta si veriu im
ejani si mëngjes vere
mbushni këngën cicërime.

Dhe visheni ngjyrëshumë
si ylberi të ma bëni
po m'u vak syri për gjumë
zgjomëni, të fle mos më leni.

Të presim agimin bashkë
edhe gonxhen të hap gjirin
të fjalosemi avash
mos u prishim avenirin.

Pastaj, merrni fluturimin
të teftisura, a lehtë
mua tek kënga më lini
e ju lodroni me djemt.

O ju, të bukura vasha
sonde mos më lini vetëm
po s'gjeta tek ju burimin
thomëni, ku ta gjej tjetër?

Dëshmorit pionier, Qebir Balili

Dua të të shkruaj vargje
ma do shpirti të ti shkruaj
ti më thua, Zaho hajde
dhe gjemë në dhe të huaj.

Gjemë atje në Verushë
në atë dimër të sertë
s'matej bora më pëllëmbë
po matej me bajonetë.

Shkelnim përmbi gjurma gjaku
vetëm gjaku e shkrin borën
do më thuash , kush e preu
pemën e bukur që mbollëm?! . .

Zemrën e tij e kam në gji

Zemrën e tij e kamë në gji
se zemra e tij është Shqipëria
ajo ka lindur poetë në përjetësi
por mbi Dritëroin asnjë s'do vija

Zemra e tij asht i stërllashtë
është det i egër e liman i qetë
është uragan e suferinë bashkë
lëndinë me lule, bjeshkë virgjëreshë.

Ndaj lumi i këngës së tij të më marrë
dhe breg më breg të më përplas
e di që do më nxjerrë në anë
më vargun Naimjan të flas.

Dhe këngët e tij do udhëtojnë nga Lenia
përndezur në vallen devollitçe
pa pyetur ku ndodhet Labëria
do hyjnë në odat e miqve.

Dhe arra e madhe në mes të oborrit
do ulë degët që t'i përshëndes
sa lidhur kokrrat në mes të qershorit
për Dritëro Agollin do t'i pyes.

Kënga e doriut

Shkon lëndinës një dori
hingëllinte si ai
derthte lotët si njeri
rënë i zoti në pusi.

Shkon doriu turfëlluar
me buzë të shkumëzuar
me gjak jelenë mbuluar
amanetin pa mbaruar.

Shkon doriu, more shokë
flisni në i flisni dot
se kishte një trimë për zot
kush e vrau dot se thotë.

Shkërmon dhenë doriu i shkretë
dhe asnjë nuk lë ta ngasë
kanë kaluar qindra vjetë
dhe doriu s'do të flasë.

O ju njerëz, o ju miq
mos harroni dorinë
se dorinj nuk ka të ligj
kë mbajnë mbi supe e dinë.

O vezir ku më mbete

Del pashai në bedenë
dhe kërkoi nargjilen
tym si dy a tri herë
hodhi synë mbi serasqerë.

Dorën përmbi mjekër shkoi
thinjur mjekra në beteja
gjithë luftrat i kujtoi
dhe iu nxi balli si reja.

Ktheu kokën, rëndë-rëndë
si dinte vezir Aliu
sa trokiti një pëllëmbë
Thanas Vaja sikur mbiu.

Thanas Vaja lekëljoti
të më bësh gati takëmë
flakë të ndizet baroti
kur unazën të kem dhënë.

E di se ç'do stambolliti
bir'i bushtrës e di ç'do
do shqipen në gjak jeziti
dhe Alin, domosdo.

O Vezir e ku më mbete
kush tjetër mbeti si ti?
u deshën dy kontinente
të mbajnë një Ali.

Ethet e gushtit më zunë

Po më plasi buza
një pikë ujë s'më dhe
ca ethe të gushtit
m'u bënë havale.

Më prunë doktorë
e nga nuk i prunë
ca bërë një orë
ca dy ditë udhë.

Më vinin tek shtrati
llojë e soj dervishë
ca me mjekër ruar
e ca me këmishë.

Ca më jepnin barna
ca më nomatisnin
ca flisin me vete
ca zinin gërthisnin.

Unë digjesha furrë
e shkrija si prushi
thoshin iku djali
janë ethe gushti.

Dhe erdhi një plakë
e njohur në lagje
në rini të saj
kish patur maraze.

Më pruri një letër
e më tha një fjalë
sot e kësaj dite
ethet s'i kam parë.

Mbi krua të fshatit rri

Mbi krua të fshatit dola
një zë të ëmbël dëgjova
ktheva kokën e vështrova
zbriste nga mali beronja
skuqur faqja mu si molla
zbardhur gusha si dëbora
shkoi pranë, dot s'i fola
Mike, moj leshra dërrudhë
ku të baron ajo udhë
e sostë fati tek unë.

Vdekja kur të më vijë

Vdekja kur të më vijë
mikja në kokë të më rrijë
të qajë, të ulërijë
po lotët mos ti fshijë
le t'i lerë të pikojnë
ta shohë që do më zgjojnë
ta shoh, do ngrihem prapë
si i marri nëpër natë
nuk fle dot po s'fjetëm bashkë.

Më vështron nga perëndimi

Një kasolle mbetur shkretë
në mes të qytetërimit
i tund supet sertë-sertë
me vështrim nga perëndimi.

E nxirosur, e mjeruar
e kapitur, e haruar
e ritur, e rrënuar
e djegur, e përvëluar.

Furkat gati më të rënë
edhe qycja nuk pushon
kukuvajka në një pënjë
ditë e natë, e vajton.

Krokëllin kur fryn stuhia
eshtrat ngroh kur vjen behari
limonisur nga fytyra
si i vdekuri nga varri.

Buzë harruar nëpër këngë
mbledh thërrimet një nga një
ka një lot aq të rëndë
gurë e drurë njomen me të.

S'i qeshi buza njëherë
dhe shpresa s'iu shua kurrë
fishken foshnjat që sa lerë
dhe kasollja pret një burrë.

U hapa plagë të rëndë "Robert Merajt"

Vjen një lajm e tund dynjanë
ne atë sabah të thellë
ulërimat natën çanë
foshnjave ëndrrat iu prenë.

Pa ngreu , ti nënë e mirë
dhe ti nuse ëndërrshuar
me lot të ma lani synë
kokën më mbani në duar.

Dhe ti motër, shpirt i shpirtit
Vishi rrobat, nise zinë
kaq i sertë ky fillimviti
se la fëmijët jetimë.

I hapa të rëndë plagë
besomëni, s'desha vetë
zunë udhën e më vranë
sisë më sisë, një plumb i nxehtë.

Djemtë sillmëni te varri
ti mar gjyshi për dore
për ta do më djegë malli
s'u flas dot një fjalë goje.

Tek molla në mes qytetit
atje pranë komitetit
vemi mëngjes pas mëngjesi
doemos me ne dhe Berti.

Mësuesit tim

"Nevruz Bektashit, me nderimin e gjithë brezave,
që u mësoi abetaren"

Sa herë marr penën në dorë
nëpër gërma shfaqesh ti
mësuesi im, aq i përkorë
që prehesh në përjetësi.

Dheu i ftohtë, që ke mbi vete
nuk e mban sot shpirtin tënd
ai vjen e tek ne tretet
zemërmadhi gjithë mend.

Më dhëmbka zemra, mësuesi im
më dhëmbka këtë natë aq shumë
mësuesit nuk kanë perëndim
mësuesit për kombet, ngulin gurë.

Ai shënjëraku burrë

Ai shënjëraku burrë
që s'ma bërrë qejfin kurrë
ditë e nat' vdekur për gjumë
kush ma mbështeti kërcunë.

Ai burri me lezete
bërë ta tundësh në djepe
mbeti me duar në xhepe
ç'i do dhe ato alete.

Shyqyr unë, o shalabran
shokët u bënë me stan
tri cangadhe mezi mban
lopët shterpë e një hajvan.

Ah, moj plaka vilivuqe
jeta jote gjithë huqe
hardalisur e s'u zbute
tendosur si tel lahute.

Po rri urtë, moj gaxhgaune
kot i hyre kësaj pune
ai që në djep e tunde
edhe sot të heq për hunde.

Mos harro, moj zogëlarë
që azgjë s'më është tharë
jam ai që jesh më parë
më njeh gjithë nj mëhallë.

Moj mendia ime lanete

Mëngjesi sa lau natën
dhe gonxhia sa u bë lule
si xhinde ëndrra m'u shfaqën
sy thëllëza asaj udhe.

Dy thëllëza grykëzëna
i pyeta ku më venë
n'atë stan tek bëhet kënga
lërna se s'ta kemi ngenë.

Më e vogla sylarushe
më ngjiti syrin për buze
ajo tjetra bilbilushe
përdridh gërshetin mbi supe.

Moj mendja ime lanete
i do të gjitha për vete
gardh baçeje mbete
njërën zgjidh, e pastaj qepe.

Tek burimi i zallit

Ballin tim e ftoha
në borën e malit
gjirin e zhuritur
tek burimi i zallit.

Këngën e harruar
gjeta majë lisit
ku është lauresha
që gjirin ma grisi.

Ku është lauresha
si në djalëri
dua që ta gjej
po nuk di se si.

Më lanë veç kujtime
që më ndezin mallin
afsh i nxehtë i tyre
e shkërmoq stërrallin.

Ku është lauresha
thomëni në e patë
kur këputen yje
a ku mbruhet natë?

Ballin tim e ftoha
në borën e malit
buzën e zhuritur.
lauresha s'falin.

Udhën të merrje të vije

Atje sipër në pallçie
është një pishë, ç'bën një hije
thëllëz'e bukur ta dije
udhën të merrje të vije
gjumë për vapë të bije
të bije gjumë për vapë
të bëje gjumë të gjatë
të të puthja pak nga pak
të merrte gufari flakë.

Ç'jemi para kombit

Në qafë të kombit
shalë politikanësh
me thembra rrahin ijet
me thonj gërvish ballët.

Në kurriz të kombit
llojë-llojë oktapodë
këmbët nuk u dalin
hanë e s'ngopet dot.

Në këmbë të kombit
pleksur fortë një ferrë
kombi kërkon udhë
ferra s'do ta lerë.

Kombi kërkon dritë
kombi kërkon jetë
ferra do të çjerrë
gjakun e do vetë.

Kombi, jo nuk është
veç një gjeneratë
ai brenda gjirit
mijra breza bashkë.

Ndaj uleni kokën
uleni të gjithë
Ç'jemi para kombit
një jetë, një pikë.

Në gushën tënde të bardhë

I ngjita buzët shushunjë
në gushën tënde të bardhë
sytë mbylla si për gjumë
buza jep e s'kish të tharë.

Ato lule ç'kishin bërë
mbledhur aromën të tërë
n'atë gushë e kishin vënë
për të tjera s'kishin lënë.

Moj me qumësht e ke larë
a ka rënë bor'e parë?
dritën e hënës ke marrët
apo lulekaçet rradhë?

Unë i mjeri sa e pashë
u vilanisa e rashë
ç'është kështu me mua thashë
dhe paputhur vend nuk lashë.

Ajo gushë me gjerdanë
bor'e pashkelur në male
e bukur e hane-hane
nazet si nepërk'e larme.

Shtati yt, hire stolisur

Vashë, Zoti ç'të kish dhënë
ballin të bukur si hënë
syrin si qielli i tërë
faqen si mollë pangrënë
qerpikun të shkelur lënë
gushën me gjerdan zënë
gjirin, sikur qoftë thënë
atje kokën kisha vënë
mesin, unazë argjendë
si duron, e s'mi ke dhënë
shtati yt hirestolisur
vjen më përkëdhel në gjumë
unë i mjeri çakërdisur
çikëloj e ndizem furrë.

Ku shkon thëllëza beharit

Ku shkon thëllëza beharë
tek çelin lulet më parë
tek bien cula, longarë
tek lot bejka me çobanë
tek s'ka burimi të tharë
tek i them vashës dy fjalë
tek më tha, ç'më nget o djalë
tek fryn flladi lehtë-lehtë
tek më ka kënga lezet
tek londroj fletë më fletë
tek përkëdhelem me retë
tek ngre balluken zefiri
tek pëllcet jelekun gjiri
tek tretet syri tek syri
tek s'i sos këngët bilbili.

Andej lart në ato male

Ç'deshe moj në Kamenicë
se më prishe gjithë çalldëmë
un'prisja të vinte ditë
habita kur doli hënë.

S'qenë pjekur ende fiqtë
gushti vendin s'e kish lënë
paduruara hardhitë
prisnin të bëheshin nënë.

Andej lart në atë male
një rrebesh i madh kish rënë
shirat që bien beharve
të pabesë, pusinë e ngrënë.

Doli lumi cit'më citë
doli lumi e nuk hidhet
po mos u mërzit, moj vitë
se do flemë në kalidhe.

Në kalidhe vllaqiko
siç i themi asaj ne
ta them unë, zemëro
do gdhiesh si kokërr thane.

Kështu vuajnë të gjitha?

Nuk më thua, moj e mirë
s'do apo s'e thua dot
sa herë erdha i pirë
pse gjeja syrin me lot?

Unë bëhesha i shkalë
dhe prapë puthja rakinë
lot'i parë ende patharë
i dyti merë rrokullime.

Dhe ashtu i handakosur
majta dhomën pash më pash
ç'ishte dhoma aq e vogël
loti yt më ndiqte pas.

Përhumbesha nëpër këngë
dhe kotesha përmbi vargje
pena s'më dëgjonte zënë
loti vështrimin s'ma ndante.

Dhe ngrihesha i dallëdisur
ç'plasje ka kënga me mua
ai lot në faqe mpiksuar
si një premtim i harruar.

Nuk më thua, moj e shtrenjtë
nuk di që ta them vet
kështu vuajnë të gjitha
që martohen me poetë?

I hoqëm gjirit rininë

Nuk e shihni Shqipëtar
si e bëmë Shqipërinë?
udhëve, çarë e përçarë
gjirit i hoqëm rininë.

Nuk e shihni, mor të mjerë
ç'heq e ç'vuan Nëna jonë?
tharë djepi, mbetur shkretë
shtrirë dorën në gjitonë.

Nuk e shihni robazezë
lotin në qerpik ngujuar
nuk e shihni të pashpresë
zemërvrar, rrudhashtuar?

Po mblihduni që të tërë
si në kohra te bajraku
përse duhet që të derdhim
në dymijën rrëke gjaku?

Hodo Nivica furtunë

"I shkreti Hodo Nivicë"
bën dyfek në Podgoricë
bën dyfek e tund dynjanë
s'i dhëmb plaga që ka marrë.

S'i dhëmb Hodos, i dhëmb Shkodrës
i dhëmb tërë Malësisë
qylafi i bardhë borë
kuqur me gjakë i gjithë.

I kuqur, s'mbetur të bardhë
po me trimërinë larë
Hodo, Hodo Aliu
të vjen kënga pas vetiu.

Ai Hodo Kurveleshi
po në Podgoricë ç'deshi
qe lëshuar, malazezi
të mirr Shkodrën, por s'i ndezi.

Hodo Nivica furtunë
më vijtë vitet e tua
n'ato vite dhe unë
se Ballkani s'u shërua.

Galinë, lule Vasjari

Zunë gjethet fëshfërijnë
zunë borërat të shkrijnë.

Lule, Vasjari Galinë
shtatë nure bukurinë.

Ëndërrushe moj Galinë
sa të panë e nuk t'u ngjinë?

Zunë beharët të vinë
t'u mbush gusha me dafinë.

Ëngjëllushe, moj Galinë
na mbushe me rrushkullimë.

Zunë lulet vesë pinë
t'u mbush gjiri trëndelinë.

Bibilushe, moj Galinë
mos shko se na mpive synë.

Një kandil për varfërinë

Një kandil për varfërinë
mbajte ndezur nëpër botë
vitet flakën nuk ia mpinë
i ndezur është dhe sot.

Sa i madh qe shpirti yt?
ku ka masë për atë shpirt
det i thellë pa fund e anë
ndaj e mori Zoti pranë.

Gonxhe, kush të njohu Gonxhe?
veç e shtrenjta nëna jote
ëngjëll dërguar për ne
si duron e rri atje?

Po hajde, Nënë Tereza
te ky troll ku kemi lerë
shëro njerëzit e pashpresë
siç i shëroje njëherë.

Moj nepërka gushlarike

Nepërk' e larme, s' më thua
ç'ke që shkon e s'flet me mua
kur merr udhën për Pihua
vij pas nazeve të tua.

Nepërk' e larme në Fier
më del që parënë diell
më del, dielli parënë
si halli që më ka zënë.

Halli që më zuri mua
ardhtë në hallet të tua
në buzë të tua ardhtë
mua me vete më marrtë.

Moj nepërka gushlarike
ti që e del në shtigje
që të flas e nuk përgjigje
o nuse, o të bëj mike.

Trifili me katër fletë

Ku e tret vështrimin syri
ja tek buza ja tek gjiri
ja në gushë, ja në faqe
ja ku thot' vetulla hajde.

Ku më rri syri i tretur
në mollzat prushëruar
në balluken e harduar
përkëdhel e s'ka të shuar.

Ku më bredh syri azat
n'atë shtatin njomzak
n'atë hapin fluturak
si sorkadhja nëpër natë.

Kur bëhet syri kandil
ja në maj e ja në prill
kur bredh lëndinës si bleta
për tërfilin me katër fleta.

Në ato vendet e mia

Në ato vendet e mia
kush ka qënë dhe e di
buron ujët nga lajthia
dimri borë, vera freski.

Bie vesa mjegullirë
që në luadh e përtej
ia merr thëllëza pagdhirë
dhe bilbili zë t'ia kthej.

Shkon çobanka m'u si vitë
supeve një lahuri
qielli sa plasur ditë
dhe sa nisur një veri.

Ulet çlodhet në një bigë
diç kërkon me sy
përmbi vetull ka një pikë
si ka mbirë aty.

Si mbiu se s'kish rrënjë
vallë, kush e pa
çobani ndënë një pënjë
pa marrë sabah.

Në ato vendet e mia
kush ka qënë dhe e di
të vjen prapë djalëria
ku ujë burimi pi.

Më tregon udhët e tua

Puthmë poezia ime
edhe kurmin ndizma zjarr
ti më fut në ëndërrime
ti më vdes e ti më ngjall.

Ti më bën të kalëroj
të pafundmen hapësirë
ti më bën të furfulloj
kur vargu nuk të ngjitë mirë.

Ti më bën stërrallin gati
ti më jep në dorë masatin
ti më bën të shkrep inatin
ti më bën që të mat hapin.

Më tregon udhët e tua
më shpie atje ku dua
nuk më ndahe asnjë thua
le vetën e rri me mua.

Ti më ngroh nëpër acar
ti ma bën shpirtin behar
ti më jep mjaltin e parë
ti di ta zgjedhësh nektarë.

Puthmë, poezia ime
se nuk ndjekam dot pa ty
po si do ishte kjo botë
po të mos kishte poezi?